

20051121543

L I G J

PËR NGARKIM ME BORXH TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË ME HUA NË QEVERINË E REPUBLIKËS SË ITALISË PËR REALIZIMIN E FAZËS SË DYTË NGA PROGRAMI PËR RACIONALIZIM TË ADMINISTRIMIT DHE MODERNIZIMIT TË TEKNOLOGJISË BIOMJEKËSORE NË SEKTORIN E SHËNDETËSISË

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet me hua në shumë prej 2.582.285 euro në Qeverinë e Republikës së Italisë për realizimin e fazës së dytë të Programit për racionalizim të administrimit dhe modernizimit të teknologjisë biomjekësore në sektorin e shëndetësisë

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të mjeteve nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshjen për ndarjen e huas e cila do lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë dhe me Marrëveshje financiare që do të lidhet ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Maqedonisë dhe bankës Artigiansassa S.p.a-Itali.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për ndarjen e huas do ta lidhë ministri i Financave.

Neni 3

Në emër të Qeverisë së Republikës së Italisë, aktivitetet financiare të lidhura me huan do t'i kryejë Banka Artigiansassa S.p.a.

Neni 4

Republika e Maqedonisë huan do ta shfrytëzojë nën këto kushte:

- Kamatë: 0,00 %;
- Periudha e pagesës 39 vjet dhe
- Grejs periudhë të kyçur në periudhën e pagesës 19 vjet;

Nëse prej çfarëdo lloj shkaku obligimi sipas kryegjësë nuk paguhet në afatet e parapara për servisimin e detyrimeve, Republika e Maqedonisë do të jetë e obliguar të paguajë kamatë ndëshkuese në lartësi prej 2,6%. Lartësia e kamatës ndëshkuese do të harmonizohet periodikisht me shkallën komerciale referente të kamatës të shpallur në bazën mujore nga ana e Organizatës për Bashkëpunim ekonomik dhe Zhvillim -OECD.

Huadhënësi, përmes Bankës Artigiansassa S.p.a. nuk do të përlllogaritë kamatë ndëshkuese për 35 ditët e para pas ditës së arritjes së detyrimit. Pas kalimit të 35 ditëve nga dita e arritjes së detyrimit, do të përlllogaritet kamata ndëshkuese deri në ditën e servisimit të obligimit kreditor.

Neni 5

Shfrytëzuesi i mjeteve të huas si dhe implementues i Projektit është Ministria e Shëndetësisë.

Të gjitha obligimet financiare nga Marrëveshja financiare do t'i kryejë Ministria e Shëndetësisë me mjetet e parapara në buxhet për vitin rrjedhës apo me shfrytëzimin e mjeteve nga buxheti i Fondit për sigurim shëndetësor i Republikës së Maqedonisë, në afatet dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen financiare.

Neni 6

Republika e Maqedonisë, huan nga neni 1 i këtij ligji do ta paguajë me mjetet e parapara në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Neni 7

Në rast se Ministria e Shëndetësisë nuk i servison me kohë obligimet në bazë të kryegjësë në afatet e përcaktuara me Marrëveshjen financiare, Ministria e Financave ka të drejtë që të mos miratojë shfrytëzimin e mjeteve të parapara në buxhetin e Republikës së Maqedonisë për Ministrinë e Shëndetësisë dhe të bëjë ridedikim të mjeteve të planifikuara buxhetore për vitin rrjedhës deri në shumën të cilën Republika e Maqedonisë në vitin rrjedhës ia ka borxh Qeverisë së Republikës së Italisë.

Neni 8

Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi për Sigurim Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë do të lidhin marrëveshje me të cilën do të rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella për realizimin e fazës së dytë të Programit për racionalizim të administrimit dhe modernizimit të teknologjisë biomjekësore në sektorin e shëndetësisë.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.